



Datë: 03.03.2025
Numër Protokolli: 1597/2025

A.nr.121/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.121/2025 të datës 17.01.2025, të parashtruar nga ankuesja V.A, kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “Kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.121/2025 të datës 17.01.2025, të parashtruar nga ankuesja, V.A.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, V.A (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 13.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 333/2025, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.121/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 27.10.2024, mbi të cilin akt i është refuzuar aplikacioni, për Konkursin me numër reference RN00015136, i shpallur me datë 13.09.2024 nga Inspektorati i Punës, për tetë (8) pozitat e punës “*Inspektor i Punës*” pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Prizrenit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankueses ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, **sepse:**

Nga provat e administruara të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës, më datë 13.09.2024 ka shpallur Konkursin publik me numër reference RN00015136, për tetë (8) pozitat e punës “*Inspektor i Punës*” pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Prizrenit, ku afati për aplikim ka qenë nga data 14.09.2024 deri më 13.10.2024.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar 169 kandidatë, ndërsa prej tyre kriteret e konkursit i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në listë të ngushtë 91 kandidatë, rrjedhimisht nga këto shkresa rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, i cili sipas Vendimit të datës 27.10.2024, të Njesisë së Burimeve Njerëzore, është njoftuar se aplikacioni i tij është refuzuar ngase nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme mbi vërtetimin e përvojës së punës të kërkuar me shpalljen e konkursit përkatës, duke mos plotësuar kështu kushtet e konkursit për të kaluar fazën e verifikimit paraprak.

Tutje, Njësia e Burimeve Njerëzore e Inspektoratit të Punës, më datë 24.12.2024 ka publikuar Njoftimin me numër protokolli 3380, për shpalljen e kandidatëve fitues, nga i cili njoftim rezulton se kandidati F.B me gjithsejtë 82.8 pikë të arritura, kandidati A. Xh me gjithsejtë 79.4 pikë të arritura dhe kandidatja M.M me gjithsejtë 71.2 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, janë shpallur kandidatë fitues për tetë (8) pozitat e punës Inspektor i Punës pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Prizrenit.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se ka bashkangjitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas shpalljes së konkursit.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses të parashtruara si në ankesë, thekson faktin se objekti i kësaj ankese është i njëjtë me objektin e ankesës për të cilën Këshilli ka vendosur me Vendimin A.nr.74/2025 të datës 27.02.2025, me të cilin vendim është anuluar në tërësi Konkursi me numër reference RN00015136, për tetë (8) pozitat e punës “*Inspektor i Punës*” pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Prizrenit, i shpallur më datë 13.09.2024 nga Inspektorati i Punës, si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, duke qenë se me Vendimin A.nr.74/2025 të datës 27.02.2025 është anuluar në tërësi Konkursi me numër reference RN00015136, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: ***“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”.***

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.121/2025, të datës 17.01.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.121/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, V.A;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së